



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 419/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Iniciativës Qytetare Lista Sërbe, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet e palejuar ankesa e Iniciativës Qytetare Lista Serbe.

Arsyetim

PZAP-i me datën 27. 06.2014, ka pranuar një ankesë nga Iniciativa Qytetare Lista Sërbe kundër vendimit të KQZ-së të datës 26.06.2014 përshkak të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës lidhur me shpërndarjen e vendeve në parlament bazuar në numrin e votave të fituara. Parashtruesi i ankesës kërkon që të ndryshohet vendimi i KQZ-së sipas së cilës Iniciativës Qytetare Lista Serbe i janë caktuar 9 vende parlamentare edhe pse në bazë të rezultateve zgjedhore prej 5.22% dhe në përputhje me nenin 111 paragrafi 2 të LQP-së ajo ka të drejtë të marrë pjesë më tej në shpërndarjen e 100 vendeve parlamentare të mbetura pasi që kanë fituar 5% të totalit të votave të vlefshme në zgjedhjet për kuvend dhe në këtë mënyrë fiton të paktën 6 vende parlamentare shtesë. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se vendimi i KQZ-së lidhur me ndarjen e vendeve parlamentare është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LQP-së pasi që me këtë rast Iniciativa Qytetare Lista Serbe është privuar nga 6 vende shtesë parlament dhe se me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që ta përkrah ankesën dhe të caktoj një numër më të madh të vendeve në parlament për Iniciativën Qytetare Lista Sërbe.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se :

ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore të Iniciativës Qytetare Lista Sërbe të parashtruar ndaj vendimit të KQZ-së lidhur me shpërndarjen e vendeve në parlament, janë të palejuar që të paraqiten në PZAP, sepse PZAP-i është institucion që vendos për vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) sipas nenit 122 par.1 pikat a, b, c, d, e dhe f, meqenëse në asnjërin nga pika e lartëpërmendura të dispozitës nuk kanë rënë pretendimet e parashtruar në ankesë, PZAP-i vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118 paragrafi 1 të LQP-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 419/2014 më datën 30.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*